





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

DËGJIM I PËRGJITHSHËM BUXHETOR ME PËRFAQËSUES TË LAGJEVE DHE FSHATRAVE DHE QYTETARË TJERË PËR KAB 2025-2027

Salla e Kuvendit Komunal Skenderaj
Më 10.06.2024, ora 14.30

Ekstrakt i procesverbalit

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Përshendetje për të gjithë. Ky është dëgjimi i katërt për KAB 2025-2027. Sqaron procesin e hartimit të buxhetit dhe thekson rëndësinë e dëgjimit buxhetor. Njofton të pranishmit për projektet aktuale që janë duke u zhvilluar dhe gatishmërinë e kryetarit për të iu gjendur qytetarëve. Ju ftoj që të na ndihmoni me kërkesat e juaja në përgatitjen dhe hartimin e buxhetit. Faleminderit dhe iu ftoj të i parashtroni kërkesat e juaja!

Albulena Hoxha: Përshendetje për të gjithë! Jam nga fshati Klladërnice dhe pyetja ime ka të bëjë me ndërtimin e urave që janë të dëmtuara nga vërshimet. Kur do të ndërtohen?

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Faleminderit për pyetjen. Vërshimet e vitit të kaluar veq dihet dëmin që e kanë bërë, ku pasojat kanë qenë shumë të rënda. Sa i përket urave që janë dëmtuar nga vërshimet tashmë është nënshkruar kontrata, buxheti është i ndarë dhe do të rregullohen.

Albulena Lushtaku: Përshendetje! Në fshatin Rezallë shumë rrugë janë asfaltu, por kan mbetur edhe disa rrugë të lagjeve, apo rrugica pa asfaltuar. Kërkojmë asfaltimin e këtyre rrugëve?

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Në fshatin Rezallë dhe në përgjithësi kemi bërë investime në rrugë dhe jemi në fazën ku na kanë mbetur rrugica e që gjatësia është me metra, e jo kilometra. Ne nuk do te ndalemi. Edhe ato pjesë ku kanë mbetur pa asfaltu, do të i asfaltojmë dhe sigurisht edhe në Rezallë do të i përfundojmë ato pjesë ku kan mbetur të pa trajtuara.

Astrit Deliu: Unë jam nga fshati Çirez, ku edhe banoj. Nga parafolësja u përmend asfaltimi i rrugëve dhe këtu po lidhem edhe unë. Në fshatin Çirez janë edhe disa rrugë të lagjeve që janë të pa asfaltuara. Tashmë, po i shoh që kanë filluar të punohet në to, por pyetja ime është a do të asfaltohen?

Gjithashtu, Çirezi ka nevojë për ndriçim publik dhe trotuare.

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Faleminderit për pyetjet Astrit. Rrugët në lagjet e fshatit Çirez janë duke u trajtuar aktualisht dhe do të asfaltohen, ndërsa sa i përket ndiçimit edhe Çirezi do të përfshihet. Për trotuare e kemi parasysh dhe do t'i shikojmë mundësitë buxhetore se sa mund të investojmë.

Edhe një herë po e përmend rëndësinë e kërkesave të juaja në përcaktimin e prioriteteve, andaj ju ftoj që ta merni fjalën!

Atëherë nëse nuk ka të intersuar ju falënderoj për pjesëmarrje dhe këtu e mbylli këtë takim.

Procesmbajtësi: Albert Rexhepi

